



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 85/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “PE-VLA-KU” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: Sh “Drini Company” sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores-Tranziti i ri” me nr. të prok: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datën: 02.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “PE-VLA-KU” SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores-Tranziti i ri” me nr. të prok: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores-Tranziti i ri” me nr. të prok: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “PE-VLA-KU” SH.P.K-Prishtinë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “PE-VLA-KU” SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 06.02.2020 me nr. 85/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores-Tranziti i ri” me nr. të prok: 632-19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 27, 28, 51, 56, 57, 59, 68, 69, 70 dhe nenin 71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenet 2, 26, 27 dhe 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.02.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 24.02.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Sa i përket ri-shpalljes fitues të Operatori Ekonomik SH. “Drini Company” SH.P.K. –Organi Shqyrtues i prokurimit (OSHP) ne tre vendimet e tyre paraprake lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (Vendimi Nr. 419/19 i datës: 05.09.20198, Vendimi nr. 621/19 i datës 07.11.2019 dhe Vendimi Nr. 829/19 i datës 27.12.2019), ka vlerësuar ankesat tona si të bazuara lidhur me Operatori Ekonomik SH. “Drini Company” SH.P.K. ku ka kërkuar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim dhe që autoriteti kontraktues të veprojnë sipas LPP-së dhe dosjes së tenderit. Ndërsa në dy vendimet e tjera të OSHP ka qëndruar pranë vendimit të saj në lidhje me OE SH. “Drini Company” SH.P.K. i cili nuk i plotëson kushtet për të qenë fitues. Të gjitha këto konstatime dhe prova të bashkangjitura vërtetojnë se Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura të LPP-së Në raportin e vlerësimit IV komisioni për vlerësim konstaton se Pretendimi nr.17 - Inxhinier I komunikacionit. Duke u bazuar në dokumentacionin tenderik të dorëzuar nga OE dhe dëshmitë dokumentare për inxhinier të komunikacionit OE e plotëson kërkesën e AK. Gjithashtu ne shume vendime te OSHP si ne projekte te komunës se Gjakovës ashtu edhe ne Vendime te autoriteteve tjera kontraktuese inxhinieri Baschelor është cilësuar si devijim i vogël. Ne këtë rast duke pasur parasysh efikasitetin dhe

ekonomicitetin e projektit.

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton që anëtarin e stafit profesional i propozuar nga OE. (Besar Jetish Krasniqi) me profesion Baçelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit diplomuar me 24 shkurt 2010 nuk i plotëson kriterin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe Profesional e që është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit të Njoftimit për Kontrate dhe Dosjen e tenderit. Eksperti shqyrtues konstaton se ky kriter i vendosur nga AK-ja nuk mund të cilësohet si shkelje e vogël sepse është kriter eliminues dhe shumë kompani kanë mundur të mos e dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk e kanë pasur Inxhinierin e Diplomuar të Komunikacionit ose Master i Inxhinierisë Mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Për sa i përket efikasitetit dhe ekonomicitetit të projektit të vlerësuar nga Komisioni për vlerësim kriter për dhënien e kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës me datën 31.01.2020 ka publikuar Njoftimin për vendimin e AK-Ri-vlerësimi i IV – Ri Shpallje, Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i Ri, në të cilin Njoftim kemi pranuar Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar si arsye që nuk e kemi paraqitur certifikatën EN 62031. Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës në kërkesën e tij me e-mail këtë certifikatë EN 62031, e ka paraqitur dy (2) herë - Bashkangjitur i gjeni edhe kopjet e e-mail-et zyrtare. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, sepse Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e kërkesës për Ri- shqyrtim në bazë të Vendimit të datës 05.02.2020 Në bazë të së cilës AK e Refuzon si të pa bazuar por në Arsyetim theksohet: Për pretendimin tuaj se jeni shpallur administrativisht i papërgjegjshëm, sqarojmë se kjo është bërë për shkak të një gabimi teknik të përvjedhur nga specifikacioni (është paraqitur dy herë certifikata EN 62031), i cili nuk është vërejtur as

nga Komisioni i ri-vlerësimit e as nga zyrtari i prokurimit. Edhe po të ishit administrativisht i përgjegjshëm, prapë nuk do të plotësoni kërkesat e Autoritetit Kontraktues, sepse tenderi juaj është me çmim më të lartë... Tenderi i juaj është i pa suksesshëm për arsye se nuk i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues, sepse tenderi i juaj është me çmim më të lartë. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura, ky pretendim i OE ankues është i pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr.3 të OE "PE-VLA-KU" SH.P.K. - dega në Kosovë Prishtinë ankues për OE SH." Drini Company" i cili është shpallur fitues nga AK Komuna e Gjakovës . Në bazë të vendimeve të PSH. AK ka kërkuar informata shtese nga Operatori ekonomik te cila i ka dorëzuar ne baze te kerkese.

Aneks - Ndërtimi - Asfaltimi I rrugës në fshatin Demjan	Ndërtimi - Asfaltimi I rrugës në fshatin Demjan	Rehabilitimi dhe asfaltimi I rrugëve në komunën e Prizrenit	Asfaltimi I rrugës Pastasel - Kaznik	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regionale të Republikës së Kosovës 2017-2018	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regionale të Republikës së Kosovës 2014/2015 Prizren 2	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regionale të Republikës së Kosovës 2014/2015 Prizren 2	Lista e kontratave të cilat i ka përfunduar me sukses, kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë 10.05.2016 deri 10.05.2019
							shuma e kontratës
46,114.07	423,114.07	/	/	/	Kontrate kornize	Kontrate kornize 36 muaj	shuma e kontratës
/	Nr. Identifikues 034	/	/	/	/	/	Nr. Prokurimit
/ -	/	/	/ -	/	201,599.61	763,535.39	14.11.2014- 10.05.2015
-/	-/	333,641.40	/ -	/	389,615.72	49,666.81	10.05-2016 10.05.2017
/	/ -	319,364.84	20,640.00	260,040.22	560,985.50	/	11.05.2017 10.05.2018
46,676.20	423,114.07	/	/ -	/	/	/	11.05.2018 10.05.2019
46,676.20	423,114.07	653,006.24	20,640.00	260,040.22	950,601.22	49,666.81	shuma e realizuar
03.07.2018	29.08.2013	05.01.2016	04.07.2016	19.12.2017	14.11.2014	14.11.2014	data e nënshkrimit të kontratës
/	/	/	/	14.03.2018; 07.04.2018	27.01.2016; 04.04.2016; 30.06.2016; 06.09.2016; 20.10.2016; 16.02.2017;	20.10.2016	situacioni data e realizimit

Rekonstruktion of road Kukës - Shishtavece , lot II Kukës Region	4,126,156.78	9,276.00	Asfaltimi i rrugëve për fshatrat e komunës së Malishevës	96,969.00	Aneks - Ndërtimi i rrugës Bujar Roka - pjesa jugore e qytetit	64,417.87	Ndërtimi i rrugës Bujar Roka - pjesa jugore e qytetit	688,777.89
CWC/ ICB/2013/ WL-rec-54-1		/		62500.18.044.52 1	632-16-081-511	632-16-081-511	632-16-081-511	
1,638,450.50	/	/		/	/	/	/	
/	/	/		/	64,917.87	64,917.87	688,777.89	
/	/	9,275.00		96,969.00	/ -	/ -	/	
/	/	9,275.00		96,969.00	64,917.87	64,917.87	688,777.89	
28.04.2014	/	/		18.06.2018	23.10.2017	23.10.2017	01.06.2017	
per ketë kontrate duhet te kërkojen situacionet e realizuar sipas datës , sepse cinae Akt vlerësimi numimet		/		/	/	/	/	
shuma e realizuar ne periudhën tre vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë 10.05.2016 deri 10.05.2019		3,263,684.52						

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e ofertës si dhe dokumentacionit të dorëzuar në bazë të kërkesës për informacione shtesë të cilat i kam pranuar në shqyrtim dhe për të cilat autoriteti kontraktues në bazë të raportit të vlerësimit konstaton se “Operatori ekonomik ka paraqitur listën e kontratave të cilat e përmbushë kërkesën për kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) në tri vitet e fundit në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€” Me poshtë po jap listën e kontratave të realizuar të natyrës së ngjashme në 3 (tri) në tri vitet e fundit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik për të cilat janë dhënë të gjitha shënimet e nevojshme për konstatim se sa është vlera e realizuar e punimeve në bazë të kontratave të paraqitura. Siq shifet nga tabela e dhënë me poshtë në bazë të dokumentacionit të ofruar me oferte si dhe të dorëzuar sipas kërkesës për plotësim të dokumentacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktues me datën 20.01.2020, Kontrata

“Rekonstruktion of road Kukes -Shishtavece , lot II Kukës Region” me numër: CWC/ ICB/2013/ WL-rec-54-1 është lidhur me date: 28.04.2014 dhe ka përfunduar me date 30.06.2016 pra 20 dite pas datës 10.05.2016 qe është date 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë 10.05.2016 deri 10.05.2019 , për këtë kontratë duhet te merret për vlerësim vetëm situacioni i fundit i pagese te cilën operatori ekonomik nuk e ka ofruar as pas kërkesë për plotësim te dokumentacionit nga Autoriteti kontraktues.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 26.02.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 24.02.2020 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 02.03.2020, ku ishin prezentë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues përfaqësuesit e OE-së ankuese, , ndërsa përfaqësuesit e AK-së nuk janë prezent ne seance, te njëjtit janë njoftuar ne mënyrë te rregullt për mbajtjen e seancës, të njëjtit nuk kanë njoftuar me arsyen e mos prezencës se tyre në seance, ne seance prezent është edhe eksperti shqyrtues profesional i prokurimit, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE ankues znj. Morina deklaroj: Te nderuar, ju faleminderit për ftesën në seancën për ri-shqyrtimin e lëndës për tenderin : Ri Shpallje, Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i Ri” me numër të prokurimit : 632-19-2998-5-1-1, me Autoritet Kontraktues: Komuna e Gjakovës.

Pas kërkesë së Autoriteti Kontraktues: Komunës së Gjakovës me datën 20.01.2020 për ti sjelle në afat prej dy (2) ditësh dokumentacioni e munguar. Këtë Dokumentacion : Të gjitha produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara: EN 60598-

1 (2015); EN 12352:2006; EN 61000-3-2; EN 62031; EN 61347-1; EN 61347-2-13; EN 61547; EN 62031; EN 55015; EN 62471. Këtu vërehet se Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës në kërkesën e saj, ka përsëritur dy (2) herë Certifikatën për Standardin EN 62031. Në afat prej dy (2) ditësh, me datën 22.01.2020, kompania jonë “PE-VLA-KU” SH.P.K i ka dorëzuar të gjitha sqarimet e kërkuara tek AK: Komuna e Gjakovës, në dy (2) mënyra fizike dhe elektronike.

Me datën 31.01.2020, Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës ka dërguar Letrën standardë për tenderuesin e eliminuar, duke na eliminuar për arsyeje se tenderi i kompanisë tonë është administrativisht i pa përgjegjshëm duke mos e sjell certifikatën EN 62031, si dhe duke e shpallur fitues operatorin ekonomik “Drini” Sh.P.K, operator të cilin Organi Shqyrtues i Prokurimit “OSHP” në tri (3) vendimet e veta e ka shpallur operator ekonomik të pa përgjegjshëm.

Me datën 03.02.2020, ne kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim tek AK: Komuna e Gjakovës me arsejnë e pretenduar nga AK: Komuna e Gjakovës për të na përzgjedhur si një Operator Ekonomik të papërgjegjshëm administrativisht, ky pretendim nuk qëndron pasi që ne e kemi paraqitur edhe certifikatën EN 62031, kjo mund edhe të vërtetohet edhe në dokumentet të cilat i kemi dërguar në dy (2) mënyra, në kopje fizike dhe elektronik. Ndërsa sa i përket shpalljes fitues të operatorit ekonomik “Drini” SH.P.K , OSHP në tri (3) vendimet e veta paraprake: Vendimi nr.419/19 ,i datës 05.09.2019, Vendimi nr.621/19, i datës 07.11.2019 dhe Vendimi nr.829/19 i datës, 27.12.2019, i ka vlerësuar ankesat tona si të bazuara lidhur me Operatorin Ekonomik “ Dini “ SH.P.K, si dhe ka kërkuar që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe që AK: Komuna e Gjakovës të veproj sipas LPP-se dhe Dosjes se Tenderit.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës me datën 05.02.2020 ka sjell Vendimin, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën ton për ri-shqyrtim të datës 03.02.2020 kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, e ka vërtetu këtë njoftim të datës 31.01.2020. Në arsyetimin e vendimit të vet AK: Komuna e Gjakovës: ka thënë se ka shqyrtuar kërkesën ton dhe në lidhje me pretendimin për shpalljen të papërgjegjshme ka sqaruar se ka qenë një gabim teknik nga specifikacionet teknike i cili është paraqitur dy herë si dhe po të ishim administrativisht të përgjegjshëm prapë nuk do ti plotësonim kërkesat e Autoritetit Kontraktues, sepse tenderi jonë është me çmimin më të lartë.

Me datën 06.02.2020 dorëzuam Ankesën në Organin Shqyrtues të Prokurimit “OSHP” me pretendimet tona se AK: Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje të LPP-se dhe të Dosjes së Tenderit, duke i kërkuar që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe që lënda të kthehet në ri-vlerësim si dhe AK të bëjë përmirësimin e vendimit të tij duke na rekomanduar në përshpërbllim me kontratë.

Me datën 24.02.2020, kemi pranuar Raportin e ekspertit vlerësues z.Daut Retkoceri. Në përgjigjen tonë në mendimin e raportit të ekspertit vlerësues në pajtohemi pjesërisht, pasi Certifikata e Standardit EN 62031 është përsëritur dy (2) herë në listën e kërkesës nga AK: Komuna e Gjakovës, si dhe ky gabim është

përmirësuar me Vendimin e datës 05.02.2020 dhe e njëjta ka pranuar që të gjitha certifikata e standardeve EN janë sjellë nga ne.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Retkoceri deklaroj: Mbetem pran raportit të dhënë në ekspertizë të datës 24.02.2020.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e OE-së znj. Morina deklaroj: Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që ankesa jonë dhe pretendimet tona të aprovohen si të bazuara dhe që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “PE-VLA-KU” SH.P.K-Prishtinë se sa i përket ri-shpalljes fitues të Operatori Ekonomik SH. “Drini Company” SH.P.K., Organi Shqyrtues i prokurimit (OSHP) në tre vendimet e tyre paraprake lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (Vendimi Nr. 419/19 i datës: 05.09.2019, Vendimi nr. 621/19 i datës 07.11.2019 dhe Vendimi Nr. 829/19 i datës 27.12.2019), ka vlerësuar ankesat tona si të bazuara lidhur me Operatorin Ekonomik SH. “Drini Company” SH.P.K. ku ka kërkuar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim dhe që autoriteti kontraktues të veprojnë sipas LPP-së dhe dosjes së tenderit. Ndërsa në dy vendimet e tjera të OSHP ka qëndruar pranë vendimit të saj në lidhje me OE SH. “Drini Company” SH.P.K. i cili nuk i plotëson kushtet për të qenë fitues. Më tej OE ankues shton se të gjitha këto konstatime dhe prova të bashkangjitura vërtetojnë se autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura të LPP-së. Në raportin e vlerësimit IV komisioni për vlerësim konstaton se pretendimi nr.17 -Inxhinier i komunikacionit. Tutje, OE ankues shton se duke u bazuar në dokumentacionin tenderit të dorëzuar nga OE dhe dëshmitë dokumentare për inxhinier të komunikacionit, OE e plotëson kërkesën e AK. Gjithashtu në shumë vendime të OSHP si në projekte të komunës së Gjakovës ashtu edhe në Vendime të autoriteteve tjera kontraktuese, inxhinieri Bachelor është cilësuar si devijim i vogël.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, Paneli Shqyrtues e trajton këtë çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton që anëtari i stafit profesional i

propozuar nga OE (Besar Jetish Krasniqi) me profesion Baçelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit diplomuar me 24 shkurt 2010 nuk i plotëson kriterin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe Profesional e që është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierisë mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit te Njoftimit për Kontrate dhe Dosjen e tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se ky kriter i vendosur nga AK-ja nuk mund të cilësohet si shkelje e vogël sepse është kriter eliminues dhe shumë kompani kanë mundur të mos e dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk e kanë pasur Inxhinierin e Diplomuar të komunikacionit ose Master i Inxhinierisë Mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

Sa i përket efikasitetit dhe ekonomicitetit të projektit të vlerësuar nga Komisioni për vlerësim kriter për dhënien e kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Andaj, ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues “PE-VLA-KU” SH.P.K-Prishtinë se Autoriteti Kontraktues përmes Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar e ka eliminuar OE ankues me arsyetimin që nuk e ka paraqit certifikatën EN 62031. Më tej, OE ankues shton se Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës ne kërkesën e tij me e-mail këtë certifikatë EN 62031, e ka paraqitur dy (2) here - Bashkangjitur i gjeni edhe kopjet e e-mail-et zyrtare. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e kërkesës për Ri- shqyrtim në bazë të Vendimit të datës 05.02.2020 e refuzon si të pa bazuar por në Arsyetim theksohet: Për pretendimin tuaj se jeni shpallur administrativisht i papërgjegjshëm, sqarojmë se kjo është bërë për shkak të një gabimi teknik të përvjedhur nga specifikacioni (është paraqitur dy herë certifikata EN 62031) , i cili nuk është vërejtur as nga Komisioni i ri-vlerësimit e as nga zyrtari i prokurimit. Edhe po të ishit administrativisht i përgjegjshëm, prapë nuk do te plotësoni kërkesat e Autoritetit Kontraktues, sepse tenderi juaj është me çmim më të lartë. Andaj, ky pretendim ankimor është i pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PE-VLA-KU" SH.P.K. - Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë SH.” Drini Company” i cili është shpallur fitues nga AK Komuna e Gjakovës. Në bazë të vendimeve të panelit shqyrtues, AK ka kërkuar informata shtesë nga Operatori ekonomik të cilat i ka dorëzuar në bazë të kërkesës. Paneli Shëyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se në bazë të kërkesës për informacione shtesë të cilat janë pranuar në shqyrtim dhe për të cilat autoriteti kontraktues në bazë të raportit të vlerësimit konstaton se “Operatori ekonomik ka paraqitur listën e kontratave e cila e përmbushë kërkesën për kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) ne tri vitet e fundit, në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€. Më saktë, kontrata “Rekonstruktion of road Kukes -Shishtavece, lot II Kukës Region” me

numër: CWC/ ICB/2013/ WL-rec-54-1 është lidhur me date: 28.04.2014 dhe ka përfunduar me date 30.06.2016, pra 20 ditë pas datës 10.05.2016 që është datë 3 vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë 10.05.2016 deri 10.05.2019). Për këtë kontratë duhet të merret për vlerësim vetëm situacioni i fundit i pagesës të cilën OE nuk e ka ofruar as pas kërkesës për plotësim të dokumentacionit nga autoriteti kontraktues. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit dhe në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, vlerëson se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka pasur parasysh njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, gjë që ka rezultuar me vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin jo të drejtë të ofertave. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë ri vlerësimit të ofertave të veproj konform nenit 59 të LPP-së dhe të ketë parasysh kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna Gjakovë
- 1x1 OE - "PE-VLA-KU" SH.P.K-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.